

UNIVERSITETI SHTETËROR I TIRANËS
INSTITUTI I HISTORISE DHE I GJUHËSISË
SEKTORI I ETNOGRAFISË

ETNOGRAFIA SHQIPTARE

BIBLIOTEKA
SHTETIT

398
C 93

III

TIRANË
1966

398
E95.

UNIVERSITETI SHTETËROR I TIRANËS
INSTITUTI I HISTORISË DHE I GJUHËSISË
SEKTORI I ETNOGRAFIË

~~UNIVERSITETI SHTETËROR I TIRANËS~~
~~INSTITUTI I HISTORISË DHE I GJUHËSISË~~

38874

~~29787~~

ETNOGRAFIA SHQIPTARE

III



TIRANË, 1966

REDAKSIA

Rrok Zojzi (Kryeredaktor), Abaz Dojaka (sekretar i kolegju-
mit), Andromaqi Gjergji, Fiqri Haxhiu, Hasan Qatipi.

Tirazhi: 2000 kopje

Formati 70x100/16

Stash: 2204-65

Shtypur në N.I.S.H. Shtypshkronjave «MIHAL DURI» — Tiranë

GUNA

NË VESHJET TRADICIONALE TË POPULLIT SHQIPTAR DHE TË POPUJVE TË TJERË BALLKANIKË

Larmia dhe njësia në trashëgiminë kulturore të popujve të Ballkanit u bënë tanimë të njohura dhe të pranuar nga të gjithë. Shkencëtarë të ndryshëm të Ballkanit dhe të vendeve të tjera që merren me studimet historike të këtyre popujve e kanë përqëndruar vëmendjen në këto dy anë të traditave të kulturës dhe po përpiqen të gjurmojnë shkaqet dhe të gjejnë arësyet e tyre.

Si larmia ashtu edhe njësia në trashëgiminë kulturore të popujve të Ballkanit çfaqen në çdo aspekt të kulturës, por në asnjë vend nuk paraqiten në formë më të qartë dhe më bindëse se në veshjet e tyre tradicionale, në të cilat rascyrohen me forma të gjalla e konkrete elementet e kulturës që i afrojnë ose i largojnë këta popuj me njeri-tjetrin.

Po t'i marrim në studim veshjet e ndryshme që popujt e Ballkanit i kanë patur në përdorim të përditshëm jo më shumë se gjysmë shekulli përpara, do të mahniteshim me larminë e madhe të tyre. Jo vetëm çdo krahinë, por shpesh edhe çdo fshat, bile kishte raste që edhe një grup i veçantë ekonomik-social brenda tij, kishte një veshje të vetën. Me qindra, ndoshta edhe me mijra qenë llojet e veshjeve që përdornin ata. Kombinime interesante materialesh, ngjyrash, formash, dekoresh, etj. përfitonin veshje krejt të ndryshme, që në një vështrim të parë duken pa lidhje dhe pa asnjë pikë takimi në mes tyre. Por po t'ja nënshtrijmë ato një analize të thellë shkencore, duke i lënë si një kategori në vete materialet e ndikimit oriental, qoftë si veshje të plota, qoftë si pjesë të veçanta (ato hynë në përdorim në disa krahina, dhe sidomos në qytetet e Ballkanit), do të shohim se në to ka disa elemente të përbashkëta dhe me interes të madh shkencor. Këto elemente të përbashkëta e pika takimi nuk vihen re vetëm në disa aspekte të tujshme, si në materiale, forma, ngjyra, dekore, etj., të cilat mund të jenë edhe të rastit, por në strukturën morfologjike të tyre, që nuk mund të jetë e rastit. Dhe në fakt, po t'i analizojmë veshjet e ndryshme të popujve të Ballkanit nga ana e njësisë morfologjike, do të shohim se të gjitha kanë një vijë të përbashkët ndërtimi: një këmishë që mbulon trupin, një palë tirçe që mbështjeilin këmbët, një gunë përsipër në formën e një palltoje të zakonshme, një brez në mes që përmbledh trupin; ndërsa te

gruaja kemi edhe përparësen¹⁾. Këto elemente të përbashkëta përftojnë një tip themelor të përbashkët veshjeje, aq sa një ballkanas mund të dallohet lehtë edhe nga veshja nga një banor i viseve të tjera të kontinentit.

Në qoftë se i analizojmë veshjet nga ana e larmisë së tyre, do të shohim se një pjesë e këmishës, diku është punuar me pëlhurë leshe, diku me pëlhurë liri dhe diku me pëlhurë pambuku; herë është më e gjerrë e herë më e ngushtë; në disa raste më e gjatë, në disa të tjera më e shkurtër; disa janë të stolitura në gjoks, në grykë, në mëngë dhe disa të pastolitura fare; në disa raste ajo përdoret mbi pjesët e tjera të veshjes, në disa të tjera mbrenda tyre, etj. Kështu edhe tirqet, guna, brezi, përparësja dhe çdo pjesë tjetër e veshjes ka dallimet e veta. Dhe janë pikërisht këto nuanca që përftojnë variantet lokale të veshjeve.

Është për t'u vënë në dukje se në disa raste këto veshje i largohen pak më tepër tipit të përbashkët dhe përftojnë ndryshime mjaft të ndryshme. Këto ndryshime e kanë burimin kryesisht në zhvillimin jo paralel të pjesëve të ndryshme të veshjeve. Kështu, p.sh., kur një pjesë e veshjes del mbi të tjerat, i jep asaj një formë të re. Këto çfaqje të ndryshme përbëjnë derivatet, të cilat, historikisht, lidhen me tipin e përbashkët.

Që të kemi të qartë karakterin e veshjeve të popujve të Ballkanit, elementet e përbashkëta e të ndryshme dheshkaqet e arësyet e këtyre, duhet të analizohet çdo pjesë përbërëse, duke studiuar strukturën dhe funksionin morfologjik të saj në kompleksin e veshjes. Një punë e tillë në kushtet e sotme është e pamundur, pasi mungojnë të dhënat.²⁾ Megjithatë, po përpiqemi të analizojmë vetëm «gunën»³⁾, që është pjesa më karakteristike dhe përcaktuese e veshjes së këtyre popujve⁴⁾.

Në përgjithësi shkencëtarët ballkanikë, duke u nisur nga bazat kombëtare, e kanë analizuar këtë problem në një rreth të kufizuar dhe

1) Në vija të përgjithëshme kjo është struktura morfologjike e veshjeve të popullit shqiptar. Po këtë strukturë paraqesin edhe **Boris Zderciuc — Paul Petresco** dhe **Tancred Banateanu** për veshjen e popullit rumun («L'Art Populaire en Roumanie», Bucurast, 1946). Po këtë strukturë paraqet edhe **Maria Veleva** për veshjet e popullit bullgar («Le Costume National Bulgare à double tablier», Sofje, 1963). Edhe për popujt jugosllavë e grek, siç shihet në leteraturën ilustrative të përmëndur në vijim të këtij studimi, kjo është struktura e veshjes së tyre.

2) Ky problem mund të zgjidhet në një mënyrë përfundimtare vetëm kur të kemi një atllas etnografik të Ballkanit. Nga sa jemi informuar, në disa vende të Ballkanit po bëhen përpjekje për hartimin e një atllasi të tillë, por që këto atllase të veçanta të koordinohen në një të përbashkët, duhet të ndiqen kritere, metoda e forma pune të përbashkëta. Me zhvillimin që kanë marrë studimet e Evropës jugë lindore, shpresojmë se së shpejti do të merret edhe një inisiativë e tillë.

3) Nga kuptimi i saj fillestar fjala gunë mori kuptime të dyta; diku me këtë fjalë kuptojmë veshjen e përditëshme prej leshe në formë palltoje që përdoret në çdo stinë, diku veshjen e rëndë dimërore që përdoret vetëm për t'u mbrojtur kundër shirave dhe të ftohtit, etj. Në këtë punim është përdorur vetëm për pallton e leshtë që vishet në çdo stinë — në verë mbi këmishë dhe në dimër nën mbulojën e rëndë dimërore.

4) Që guna është pjesa më me rëndësi e veshjes popullore, pjesa determinante e saj, dëshmojnë shprehje të ndryshme popullore, si: «shikoi punën dhe jo gunën», që të cilën guna përfaqëson krejt veshjen. Edhe në Jugosllavi në ishullin Mljet, me emrin «gunj» kuptojmë krejt veshjen (Br. Gušić, vep. e cit., Nr. 6).

jo në tërësinë e tij. Për shembull. G. Opresku u përpoq të gjurmonte origjinën e gunës rumune⁵⁾; Br. Gushiçi, duke u marrë me veshjen e ishullit Mljet të Dalmacisë, u ndal në gunën që përdorej këtu dhe, për nevoja studimi, në disa raste u shtri edhe në studimin e gunës së popujve të tjerë të Jugosllavisë⁶⁾; M. Veleva, duke studiuar veshjen bullgare me prapanik e paranik, analizoi edhe gunën e saj dhe, për nevoja krahasimi, studioi edhe gunën bullgare në përgjithësi⁷⁾; Rr. Zojzi, në një studim mbi veshjet e popullit shqiptar, gjurmoi edhe origjinën e gunës së tij⁸⁾, etj. Megjithatë në këto punime, megjithëse me një bazë të kufizuar u zbrit mjaft thellë në disa probleme që lidhen me këtë objekt, por nuk u arrit në përgjithësimet në shkallë ballkanike.

Veç këtyre, edhe autorë të tjerë, kryesisht autorë jo ballkanas, u morën me studimin e këtij problemi në një formë më të përgjithëshme, në një bazë ndërkombëtare. Ndër këta përmendim Fisherin,⁹⁾ Batalian,¹⁰⁾ Nopcen¹¹⁾, Shuhardin¹²⁾, Haberlandin¹³⁾, Rozen-Przevorsken¹⁴⁾, etj., punimet e të cilëve, për mungesë materialesh, nuk kanë qënë gjithnjë të plota; si rriedhim, edhe përgjithësimet e tyre nuk kanë qënë gjithnjë të sigurtat¹⁵⁾.

Sot, që bazat materiale të punës shkencore për popujt e Ballkanit janë siguruar pranë institucioneve përkatëse dhe që janë botuar materiale e studime të veçanta, mund të themi se kanë filluar të krijohen mundësitë për studime shkencore në një shkallë më të gjërë, duke i analizuar objektet në të gjitha aspektet e tyre. Pra, duke u nisur nga gjithë këto, ne po studiojmë në mënyrë të veçantë gunën ballkanike. Por para se t'a analizojmë këtë, në mënyrë shkencore, do të shqyrtojmë shtrirjen e saj territoriale dhe disa veçori të përgjithëshme të saj.

Objekti që po studiohet, ku në një formë e ku në një tjetër, ku me një ngjyrë e ku me një tjetër, përdoret në të gjithë popujt e Ballkanit.

Në Shqipëri, me përjashtim të disa grupeve të popullsisë brenda alpeve të Veriut dhe të atyre që kanë zbritur prej tyre në fushat bregdetare, guna ka qënë përdorur në të gjithë vëndin¹⁶⁾. Deri në mesin e shekullit të kaluar ajo përdorej në Dukagjin (Shalë, Shosh, etj.), Mer-

5) G. Oprescu — «L'art du paysan Roumaine». Botim i Akademisë rumune, Bukuresht, 1937.

6) Br. Gušić — «Starinsko ruho na otoku Mljetu». Zagreb, 1930.

7) M. Veleva — «Le costume national à double tablier». Sofje, 1963.

8) Rr. Zojzi — në «Studime Historike», viti 1964; Nr. 4.

9) E. Fischer — «Die Haar — und kleidentracht vorgeschichtlicher Karpathen- und Balkanvolkerkunschaften», 1909.

10) R. Battaglia — «L'Europa Danubiano-Balkanica». (mikrofilm pranë sektorit të etnografisë).

11) Fr. Nopcsa — «Albanien» (Bauten, Trachten und Geräte Nordalbanien). Berlin u. Leipzig, 1927.

12) C. Schuchard — «Die germanischen Mäntel und das Ilyrische Röckchen», Berlin, 1936 dhe «Die Urillyrier und ihre Indogermanisierung», Berlin, 1937.

13) M. u. A. Haberland — «Die Völker Europas und Ihre Volkstumliches kultur». Stuttgart, 1928.

14) J. Rosen-Przewerska — «Spoleczna Funkcja adziezy». Varshavë, 1949.

15) Përveç këtyre, mund të ketë edhe autorë të tjerë, si nga të parët ashtu edhe nga të dytët, botimet e të cilëve nuk patëm rast t'i kemi.

16) Për materialet shqiptare u mbështetëm kryesisht në fondet e Muzeut Etnografik të Tiranës e të muzeve lokale të rrethëve, si dhe në botimet e ndryshme ilustrative.

tur. Berishë. Has. në qytetin e Shkodrës dhe vazhdon të përdoret në Postripë, Pukë, Mirditë, Lumë (Terthore)) Dibër, Mat, Martanesh, Gollobërde, Çermenikë, Shëmil, Labinot, në malësi të Leshës, Kurbin, Fush-Krujë, Shpat, Polis, Bërzeshtë, Dervend, Mokër, si dhe në pjesën tjetër të rrethit të Pogradecit; ka qënë përdorur gjithashtu në qytetin dhe fushën e Korçës, kurse në malësinë e saj dhe në pellgun e Prespës vazhdon të përdoret akoma; përdorej në Myzeqe, në një kohë më të largët edhe në Labëri e në Rrëzë të Tepelenës; përdoret edhe në Lunxhëri, Zagori, Pogon, Dropull, Vurg, në malësinë e Delvinës; gjithashtu, ka qënë përdorur edhe në Çamëri¹⁷⁾, etj.

Në Jugosllavi guna përdoret në përdorim të përgjithshëm deri në fundin e shekullit të kaluar dhe në shumë raste përdoret edhe sot. Atë e përdorin si burri ashtu edhe gruaja në Mal të Zi, Likë, Hercegovinë;¹⁸⁾ fshatarët e Kanalit, Ublinskzit, Shebenikut dhe qytetarët e Risanos. Ajo përdoret nga gruaja në Krivosie e Krushevicë dhe nga burri e gruaja në Gornja Krajina (Pirot), Gilan, Zladovçe (Kriva-Palanka) e Kumanovë; përdoret nga gruaja në rrethet e Shkupit e Manastirit, nga burri e gruaja në Trebinjë e Liçevicë (Split), nga gruaja në Djurdjevac (Osjek), etj.¹⁹⁾,²⁰⁾

Në Rumani guna përdoret në krahinat e Transilvanisë e Marmurës. Në Moldavi²¹⁾, në viset perëndimore dhe në ato jugëlindore,²²⁾ në Romavat (Kraiova), ajo përdoret nga burrat. Kurse në Timisoare, në krahinën e Bukureshtit²³⁾, sidhe në Ruteni²⁴⁾ guna përdoret si nga burri, ashtu edhe nga gruaja.

Edhe në Bullgari e ndeshim këtë objekt.²⁵⁾ Atje përdoret nga gruaja në Belogradçik, Plevnje, Provadia, Pomorie, Topolovgrad Maliko-Ternova, në rrethe të Sofjes, në Samokov, Kiustendil, Noevrekop, etj., kurse në Vidin, Botevgrad, Trau, Haskove etj.²⁶⁾ përdoret nga burri.

Guna është përdorur edhe në Greqi. Në Athinë ajo mbahej si nga burri, ashtu edhe nga gratë. Në Atikë ajo përdorej nga gratë, dhe vajzat²⁷⁾. Përdorej gjithashtu nga burrat në qytet dhe te fshatarët rreth Janinës, te barinj e baresha të Arkadies, e gra e fëmijë të rrethit të Tebës, te gruaja e Delfit,²⁸⁾ te gruaja e Sulit,²⁹⁾ Eubes³⁰⁾

17) Rr. Zojzi — Dh. Mborja — «Arti Popullor në Shqipëri», botim i Universitetit Shtetëror të Tiranës, 1959, faqet: 1, 4, 6, 8, 10, 14, 16, 18, 23.

18) Francesco Carrara — «La Dalmazia descritta». Zara, 1846.

19) W. Bruhn/M. Tilke — «Das kostumwerk», Berlin, 1941 f. 161, fig. 2, 7, 8, 11, 12.

20) Musee Ethnographique de Beograd — «Costumes nationaux jugosllaves», 1930. Fasc. I.

21) Adolf Rosenberg — «Geschichte des Kostüms», Berlin, vëll. V, f. 334.

22) Bruhn/Tilke, vep. e cit., f. 163, fig. 5, 8, 9, 10, 12.

23) «Costumes nationaux de la Republique Populaire Romaine», botim i Institutit të Rumanisë për marrëdhënie kulturele me botën e jashtëme.

24) Bruhn/Tilke, vep. e cit., f. 163.

25) Rosenberg, vep. e cit., vëll. V, f. 334, fig. 11.

26) Maria Veleva — Neva Tuzyzov — Vener Naslednikov — Georgi Atanasov. «Bllgarski Narodni Nosi Shevici», fig. 3, 8, 17, 20, 24, 31, 32, 34, 36, 37; 4, 6, 30, 41.

27) Rosenberg, vep. e cit., vëll. V, f. 336, fig. 1, 2, 3, 4, 5, 11.

28) O. M. De Stackelber — «Costumes et Usages des peuples de la Grèce Moderne», fig. 1, 3, 4, 6, 7, 9, 10, 16.

29) H. L. Pouqueville — «Voyage de la Grèce (skica të riprodhuara nga autorët e ndryshëm) vëll. I, f. 1; vëll. II, f. 176, vëll. IV, f. 120, 294, 512, etj.

30) M. u. A. Haberland — «Die Volker Europas und ihre Volkstümliche kultur» (riprodhim nga Stackelberg), në f. 129, 144.

dhe Crigut³¹), të shqiptarët e Greqisë,³²) etj. Pra siç shihet, gjer në fundin e shekullit XIX guna që një pjesë e përbashkët e veshjes për të gjithë popullin e Ballkanit të çdo vëndi dhe krahine. Edhe në qoftë se në ndonjë kënd të këtij gadishulli ajo mungon, la prapa vazhden e saj, që dëshmon se në një të kaluar më të largët përdorej edhe aty³³).

Përveç përdorimit të gjërë të saj në çdo popull të Ballkanit, gunën e shohim që të përdoret edhe në çdo kategori të tyre, pa dallim seksi, moshe dhe gjendjeje shoqërore: Ajo është në përdorim të mashkullit e të femrës, me ndryshimin se tek i pari ajo ka qenë më e thjeshtë, kurse tek e dyta më e zbukuruar. E gjejmë në përdorim nga çdo moshë, me ndryshimin se tek të rinjtë e pleqtë ajo paraqitet e thjeshtë, kurse te dhëndri dhe nusja shumë e stolisur. E gjejmë te i pasuri dhe te i varfëri, me ndryshim se i pari e ka me material më të zgjedhur e punë më të mirë, kurse i dyti me material më të dobët dhe të punuar dosido. Pra, del qartë se guna shtrihet në të gjithë popullin e Ballkanit dhe në çdo kategori shoqërore të tyre, aq sa me të drejtë mund të quhet si një veshje e përbashkët e popujve Ballkanikë.

Por, nga ky gadishull, ajo u përhap edhe jashtë tij, veçanërisht në Evropën oëndrore³⁴). Ballkanasit e emigruar e mbajtën dhe e përdoren atë edhe në vise të tjera të kontinentit,³⁵) ku ata emigruan. Etnografët e shquar M. e A. Haberland, të cilët u morën me percaktimin e arealit të këtij objekti, kanë shprehur mendimin se shtrirja teritoriale e tij gjendet në lindje të vijës Adriatik-Vistulë³⁶).

Nga studimet e deri tanishme që i janë bërë gunës ka mendime të ndryshme, herë në pajtim dhe herë në kundërshtim në mes tyre, po për mungesë të dhënash të plota problemet e këtij objekti mbeten gjithnjë pezull.

Një ndihmë të madhe në zgjidhjen e tyre japin materialet shqiptare, të cilat deri tani ose nuk njiheshin, ose njiheshin përciptas. «Shqipëria enigmatike — thotë historiani gjerman Standtmyler, — me materialet e saj përfaqëson pikën e Arkimit për studime balkanologjike»³⁷); ose, siç shprehet më mirë historiani i madh kroat M. Shuflaj, «në Shqipëri paraqitet si në një pasqyrë i tërë Ballkani»³⁸) Pra, mungesa e materialeve shqiptare për këto studime ka qenë mjaft e ndjeshme. Por me që sot materialet shqiptare i kemi të mbledhura pranë sektorit të etnografisë dhe muzeve etnografike, po e marrin në studim problemin.

31) A. L. Castellan «Lettres sur la Morée», Paris, 1808, vëll. I, f. 39, 79, vëll. II, f. 96.

32) Janë shumë të pakta vëndet në të cilat të mos ketë gjurmë që të dëshmojnë se guna nuk është përdorur në të kaluarën. Bile edhe ato të pakta janë si ishuj të vegjël në mes të detit të hapur të gunës. Për shembull, në disa lugina të alpeve shqiptare të veriut nuk ka asnjë gjurmë që të dëshmojë se gruaja e ka përdorur këtë objekt, ndërsa për burrin gjurmat e saj i gjejmë edhe në to.

33) Gjurmët e saj jashtë Ballkanit i gjejmë: në Hungari (shih) Rosenberg, f. 338, nr. 1, 2, 4, 10, dhe f. 339, nr. 2, 4, 5; gjithashtu, Bruhn-Tilke, f. 162, nr. 5, 6, 16, 17, 18; Në Austri (shih P. Geramb në «Steirische Trachtenbuch», Graz; por edhe në Çekosllovakia, Poloni, etj.

34) Për shembull, shqiptarët dhe grekët e emigruar e mbajtën këtë objekt edhe në Itali, ku e përdorën deri në mesin e shekullit të kaluar.

35) Haberland, vep. e cit., f. 560.

36) Stadtmüller «Forschungen zur albanischen Frühgeschichte», 1941 (Hyrja).

37) Dr. M. Sufflay, etj. — Acta Diplomata I, f. 3. (Cit. nga Stadtmüller).

Gunën ballkanike po e analizojmë duke patur parasysh afërsisht 126 lloje të ndryshme të saj, të cilat, sigurisht, nuk përfaqësojnë tërë materialin, por një pjesë të tij. Nga këto, 37 lloje i kemi nga Shqipëria, 32 nga Jugosllavia, 24 nga Greqia, 18 nga Bullgaria dhe 15 nga Rumania. Materialet për këto, me përjashtim të atyre shqiptare u muarën kryesisht nga literatura ilustrative që përmëndëm.³⁹⁾

Njësinë dhe larminë e gunës ballkanike e shohim në elemente kryesore të saj, si në emrin, në materialin e ndërtimit, ngjyrën, formën, dekorat, në funksionin morfologjik, etj. Disa nga këto elemente po i analizojmë në mënyrë të veçantë.

1) Elementi më i lëvizëshëm i objektit në analizë është emri: në çdo variant të gunës gjejmë një emër të ndryshëm. Si shembull marrim emërtimin e objektit në popullsinë shqiptare dhe në ndonjë popull tjetër të Gadishullit Ballkanik. Te ne gjejmë në përdorim të popullit këto emra: «zhgun»⁴⁰⁾ — në Shalë, Shosh, Mertur, Berishë; «shingun», «shangun», «shagun», etj., — te vllahët në përgjithësi, në krahinën e Prespës, në Vurgun e Delvinës, etj.; «gunë»⁴¹⁾ — Lumë (Terthore), Martanesh, Myzeqe, Çamëri, në fshatra të Konispolit, kurse në malësi të Lezhës e quajnë «gunzë»;⁴²⁾ «xhupletë», «xhupetë»⁴³⁾ e quajnë në Kallmet; «xhup»⁴⁴⁾ e quajnë bajrakët e Ohrit, Mirditës, etj.; «cibun», «cipun» e quajnë në rrethin e Pogradecit dhe në malësinë e Korçës, kurse «zobançë»⁴⁵⁾ e quajnë në Kërçisht (Peshkopi), Gollobordë, etj.; «xhokë»⁴⁶⁾ e quajnë në luginën e Shkumbinit; «dollamë», «dallamë» — në Shkodër e Postribë; «dollomà» e quajnë në qytetet e Korçës, Leskovikut, etj.; «nemtë», «nete», «nente» dhe «mentë» e quajnë në pjesën e ulët të luginës së Matit, në Kurbin, etj.; «deleshe», «leshe», «leshnik», etj.⁴⁷⁾ e quajnë në Malësinë e Madhe dhe në disa vise të malësisë së Dibrës etj.; «gozhup»⁴⁸⁾ e quajnë në Dukagjin; «çashe»⁴⁹⁾ — në fu-

39) Si burime ilustrative kanë shërbyer kryesisht ato që u përdorën për përcaktimin e shtrirjes teritoriale të objektit duke filluar nga shënimi me numër 16 deri në atë numër 32.

40) Ky emër përdoret në të gjithë Veriun edhe për materialin e thurur në vegjë, në katerliq dhe të shkelur ashtu në formën e papunuar: të paprerë e të paqepur.

41) Ky emër përdoret edhe në Malësi të Madhe dhe në përgjithësi në Shqipërinë e Jugut, po për një objekt tjetër veshjeje, i cili nuk ka lidhje me objektin tonë, p.sh.: «gunë larë», «gunë çile» etj. (shih shën. Nr. 3).

42) Diminutiv i fjalës «gunë».

43) Kjo fjalë përdoret edhe në Malësi të Madhe, Dukagjin e Breg të Matës, po për një objekt tjetër. Te arbëreshët e Ukrainës përdoret për këpucët (shih: S. Islami, Buletin për Shkencat Shoqërore, 1955, Nr. 2).

44) Edhe kjo formë është e përhapur në të gjithë Ballkanin dhe në Evropën Jugore. hyn rishtas në popullin tonë nga turqishtja me emrin «xhybe» dhe nga perëndimi me formën xhup, për pjesë të tjera veshjeje që nuk kanë lidhje me objektin në studim.

45) Jashtë çdo kompetence etimologjike, duke u mbështetur vetëm në ngjashmërinë fonetike, mendoj se ky emër ka lidhje me fjalën çoban, çopan, etj.

46) Kjo fjalë njihet edhe në Veri, ku përdoret në proverbin «herë me xhybe, herë me xhoke» — për njeriun e paqëndrueshëm, hipokrit.

47) Sigurisht, ky emër u muar nga materiali «lesh». Nga kjo prejardhje është edhe fjala «delesh», «qelesh», etj. Fjala «leshnik» përdoret në Veri edhe në shprehjen popullore «hangre fikun — vesh leshnikun», ku terma leshnik ka kuptimin e veshjes së rëndë dimërore.

48) Me këtë fjalë në Dukagjin quajnë veshjen me lëkurë prej deleje.

49) Në Kurbi, me fjalën «tjashe» kuptojmë pëlhurën e leshtë të punuar në shtëpi nga gruaja.

shën e Dibrës; «pec» — në malësinë e Matit; «flokate»⁵⁰) e quan grua-ja labe, kurse «lëkurçe»,⁵¹) ajo, quan formën e vjetër të saj; «qesike»⁵²) e quajnë në fushën e Domosdovës: «shajake» — në disa fshatra të Vurgut⁵³), «cohë» dhe «kadife» e quajnë në Lunxheri; «shita»⁵⁴), — në Droupull. Gunën e quajnë edhe me emra të tjerë, por këto kanë një përhapje më të vogël. Edhe shqiptarët e emigruar që e ruajtën përdorimin e gunës krahas saj, e ruajtën edhe emrin kështu, p.sh. arbëreshët e Greqisë e quajnë «gunë»⁵⁵), ata të Italisë — «gunë», «gjobun» dhe «cohë»⁵⁶), të Ukrainës — «shijak»⁵⁷), kurse ata të Mandricës (Bullgari) — «gunë»⁵⁸).

Edhe te populli bullgar gjejmë një tok emra të ndryshëm për këtë objekt: «kësak» e quajnë në Komarev (Plevnje), «dollaktanka» — në Podgorie (Llom), «dreha» — në Krushov (Teteven), «kiça» — në Ravana (Provadiste), «koçak» — në Belogradiçko, «kloshnik» — në Plevensko, «gluhçë» — në Oreslec, «sglobnica» — në Vidinsko, etj., «barnik» — në Nikopplsko, etj., «veba», «abiçka», «ulek», «zebun», «çokma», «xhube» «menteto», «allaxha», etj. — në krahina lindore⁵⁹).

Nga literatura e shfrytëzuar, për variantet e këtij objekti dolën një tok emra të ndryshëm edhe në gjuhët jugosllave, rumune e greke.

Në mes të kësaj larmie të madhe emrash gjejmë forma krejt të ndryshme dhe forma të ngjashme që lidhen në mes tyre me një rrënjë të përbashkët. Për shembull, emrin nemte që e gjejmë në shqipe, e gjejmë në bullgarishte,⁶⁰) në vëndet jo Ballkanike, si edhe në hungarishten; emrat shigun, shangun, cibun, zombun, etj. i gjejmë në përdorim të çdo populli ballkanik⁶¹), etj. Këta emra me forma të ndryshme, të cilët kanë rrënjë të përbashkët, bëjnë pjesë në fondin e përbashkët leksikor të popujve të Ballkanit.

Me qënë se për objektin në studim mungon një emër i përgjithshëm, po përdorin emrin «gunë», pasi është më i përhapur dhe, siç do ta shohim më poshtë, edhe më i lashtë, kurse emrat e tjerë të veçantë do të përdoren si emra specifike për variantet e tij.

Emrin gunë nuk e gjejmë vetëm në përdorim të popullit shqiptar, por edhe ndër të gjithë popujt e tjerë të Ballkanit. Siç u përmend edhe më lart, ashtu sikurse objekti u përhap edhe në popujt të tjerë jo ballkanas, edhe emri u përhap, bile në një shkallë më të gjërë, në shumë popuj të kontinentit. Në gjuhën shqipe e gjejmë me format «gunë» dhe «gunzë», në bullgarishte — me format «guna» dhe «gunja»⁶²), në serbo

50) Me këtë emër quhet edhe «brruca» që përdor burri lab, por ky objekt nuk ka lidhje me objektin në studim.

51) Objektin të punuar me lëkurë.

52) Paraqet të njëjtin objekt, por me formë të shkurtuar dhe të zvogëluar në përgjithësi.

53) Prej turqishtes «shajak» — pëlhurë e leshtë.

54) Ndoshta rrjedh nga «hition» — i lashtë.

55) G. Meyer «Etymologisches Wörterbuch der Alb. Sp.», Strassburg, 1891, fj. gunë.

56) Prof. Ferrari — informata gojore.

57) Selim Islami — «Buletin për Shkencat Shoqërore», v. 1955, Nr. 2, «Material gjuhësor nga kolonitë shqiptare të Ukrainës», f. 179.

58) Dhimitër Shuteriqi — «Fshati shqiptar i Mandricës», në Studime Filologjike, v. 1965, Nr. 2, f. 158.

59) M. G. Veleva, vep. e cit., f. 59 dhe 107.

60) Menteto (shih M. G. Veleva). vep. e cit.

61) A. Boué — «La Turquie d'Europe», Paris, 1840, vëll. II, f. 184, 188, 213.

62) M. Vasmer — «Russisches Etymologisches Wörterbuch», Heidelberg, 1954, fjala «gun».